

VENDIM
I ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME
TË SHOQËRISË EBA 2020 sh.p.k

Sot më datë 20/02/2020, në selinë e Shoqërisë, u zhvillua Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë EBA 2020 sh.p.k, person juridik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS: M01322008N, seli në adresën "Zayed Business Center", Rruga "Andon Zako Çajupi, afër Sheshit Willson, Njësia Administrative Nr.5, Tiranë, me status aktiv, dhe me Administrator Enkel Bamllari.

Në mbledhje morën pjesë të gjithë ortakët e Shoqërisë EBA sh.p.k, të cilët përfaqësojnë 100% të kapitalit të përgjithshëm të nënshkruar të Shoqërisë, përkatësisht:

1. Ortaku Adrian Naço zotëron një (1) kuotë, me vlerë nominale gjithësej LEKË6993000 (gjashtëmilion nëntëqind e nëntëdhjetë e tremijë Lekë), e cila përfaqëson 33.3% të vlerës së Kapitalit të Përgjithshëm të Nënshkruar të Shoqërisë.
2. Ortaku Enkel Bamllari, zotëron një (1) kuotë, me vlerë nominale gjithësej LEKË6993000 (gjashtëmilion nëntëqind e nëntëdhjetë e tremijë Lekë), e cila përfaqëson 33.3% të vlerës së Kapitalit të Përgjithshëm të Nënshkruar të Shoqërisë.
3. Ortaku Besart Xhaferi, zotëron një (1) kuotë, me vlerë nominale gjithësej LEKË7014000 (shtatëmilion e katërbëdhjetëmijë Lekë), e cila përfaqëson 33.4% të vlerës së Kapitalit të Përgjithshëm të Nënshkruar të Shoqërisë.

Rendi i Ditës së Mbledhjes ishte:

1. Ndryshimin e plotë të Nenit 7 të Statutit të Shoqërisë EBA 2020 sh.p.k.
2. Përcaktimin dhe autorizimin e regjistrimit të dhënave në lidhje me emërtimin tregtar të veprimtarisë së Shoqërisë EBA 2020 sh.p.k.

Kjo mbledhje është e vlefshme për të marrë vendime për ndryshimin e statutit të Shoqërisë EBA 2020 sh.p.k, si dhe për çështjen tjetër të rendit të ditës, pasi Ortakët që marrin pjesë personalisht në mbledhje, zotërojnë 100% të numrit total të kuotave të kapitalit të Shoqërisë (votive). Gjithashtu në përputhje me nenin 12.5 të Statutit, (paragrafi i fundit), tre Ortaket e Shoqërisë deklarojnë se janë të dakord për shqyrtimin dhe marrjen e Vendimeve në këtë mbledhje në lidhje me të gjitha çështjet e rendit të ditës.

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë EBA 2020 sh.p.k, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, në përputhje me kompetencën e saj sipas Nenit 12.2/b të Statutit, me votën unanime të tre ortakëve të Shoqërisë të cilët zotërojnë 100% të vlerës së kapitalit të përgjithshëm të saj,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë plotësisht Nenin 7 të Statutit të Shoqërisë EBA 2020 sh.p.k, i cili duke filluar nga data e këtij Vendimi Asambleje e në vazhdim do të ketë si përmbajtje:



NENI 7

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

7.1 Zhvillimin e veprimtarisë tregtare nëpërmjet krijimit, hapjes dhe administrimit të Institucioneve Arsimore Plotësuese Parauniversitare Private, të cilat do të kryejnë veprimtari jashtëshkollore që pasurojnë përvojat mësimore dhe jetësore të nxënësve, duke ofruar veprimtaritë arsimore plotësuese jashtëshkollore dhe shërbimet vijuese:

- a) Kryerjen e veprimtarisë arsimore plotësuese për fëmijët e grup-moshave nga 5-12 vjeç, të cilët pas përfundimit ditor të mësimit në shkollë, do të vijnë në ambjentet e Institucionit Arsimor Privat Plotësues të shoqërisë dhe do të përfitojnë shërbime për përgatitjen dhe plotësimin e përvetësimit të njohurive të marra në shkollë, në lëndët shkencore dhe shoqërore, përfshi ndihmën për plotësimin e detyrave ditore të caktuara nga shkolla, si dhe mësimet ekstra.
- b) Kryerjen e veprimtarisë arsimore plotësuese për fëmijët e grup-moshave nga 12-16 vjeç, nëpërmjet organizimit dhe ofrimit të kurseve për mësimin e gjuhëve të huaja, si Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht, Italisht, Spanjisht dhe të llojeve të tjera, në nivelin fillestar, mesatar dhe mbi mesatar.
- c) Kryerjen e veprimtarisë arsimore plotësuese, nëpërmjet organizimit të kurseve për formimin edukativ dhe kulturor, ku ofrohet mësimi i veglave muzikore, mësimi i baletit, mësimi i pikturës, e të tjera të kësaj natyre.
- d) Kryerjen e veprimtarisë arsimore plotësuese, për fëmijët e grup-moshave mbi 15 vjeç, nëpërmjet organizimit të kurseve të avancuara, ku do të ofrohet përgatitje dhe aftësim për mbrojtjen e testeve IELTS, TOEFL, CAE, GMAT, GRE, SAT General, SAT Subjects, Advanced Placement, GCSE, IGCSE, A Level, Test Daft, Provimet e Lirimit, Maturës Shtetërore, Provime Arkitekture, etj.
- e) Kryerjen e veprimtarisë arsimore plotësuese, nëpërmjet organizimit të Kurseve dhe Trajnimeve Profesionale, ku bëjnë pjesë, Kurse për Guidat Turistike, Kontabilitetin, Kurse për mësimin e Kompjuterit dhe përdorimin e programeve të ndryshme kompjuterike.

7.2 Zhvillimin e veprimtarisë tregtare nëpërmjet krijimit, hapjes dhe administrimit të Institucioneve Private Ofruese të Arsimit dhe Formimit Profesional, të Llojit "Qëndër Formimi Profesional", në të cilat do zhvillohet veprimtari jashtëshkollore për nxënësit që kanë përfunduar arsimin bazë e sipër, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve si vijon:

- a) Organizimi dhe ofrimi i kurseve për përgatitjen dhe plotësimin e njohurive të marra në shkollë, ku bëjnë pjesë kurset për lëndët shkencore dhe lëndët shoqërore, përfshi kurset për përgatitjen dhe plotësimin e detyrave ditore të caktuara nga shkolla, si dhe mësimet ekstra.
- b) Organizimi dhe ofrimi i kurseve për mësimin e gjuhëve të huaja, si Anglisht, Gjermanisht, Frëngjisht, Italisht, Spanjisht dhe të llojeve të tjera, në nivelin fillestar, mesatar dhe mbi mesatar.
- c) Organizimi dhe ofrimi i kurseve për formimin edukativ dhe kulturor, ku ofrohet mësimi i veglave muzikore, mësimi i baletit, mësimi i pikturës, e të tjera të kësaj natyre.
- d) Organizimin dhe ofrimin e kurseve të avancuara, ku do të ofrohet përgatitje dhe aftësim për mbrojtjen e testeve IELTS, TOEFL, CAE, GMAT, GRE, SAT General, SAT Subjects, Advanced Placement, GCSE, IGCSE, A Level, Test Daft, Provimet e Lirimit, Maturës Shtetërore, Provime Arkitekture, etj.

- e) Organizimin dhe ofrimin e Kurseve dhe Trajnimeve Profesionale, ku bëjnë pjesë, kurse për Guidat Turistike, Kontabilitetin, Kurse për mësimin e Kompjuterit dhe përdorimin e programeve të ndryshme kompjuterike.

7.3 Çdo Institucion Arsimor Plotësues Parauniversitar Privat, si dhe çdo Institucion Arsimor dhe Formimi Profesional që do të hapë dhe administrojë shoqëria, do të ketë emrin "VIRTUS EXCELLENCE TRAINING CENTER".


7.4 Shitjen e të gjitha shërbimeve që përmban veprimtaria mësimore plotësuese që shoqëria do të ofrojë nëpërmjet Institucioneve Arsimore Plotësuese Parauniversitare Private të hapura dhe të administruara prej saj, personave përfitues të këtyre shërbimeve, si dhe të çdo lloj shërbimi tjetër që shoqëria do të ofrojë kurdoherë.

7.5 Kryerjen e çdo veprimtarie tjetër tregtare, e cila është pjesë përbërëse dhe do të bëhet në funksion të realizimit të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë të parashikuar në këtë Statut, përfshi zhvillimin e aktivitetit tregtar nëpërmjet hapjes dhe administrimit të "Bar-Kafeteri & Snacks".

7.6 Për cilindo nga veprimtaritë e mësipërme pjesë përbërëse e objektit të Shoqërisë, për të cilat ligji kushtëzon pajisjen paraprake me liçense nga Organet Shtetërore kompetente, Shoqëria do të fillojë zhvillimin e tyre, vetëm pas aplikimit dhe pajisjes me Liçencën përkatëse të veprimtarisë.

3. Shoqëria EBA 2020 sh.p.k, do të mbajë dhe përdorë si Emërtim Tregtar të saj:
 - "VIRTUS EXCELLENCE TRAINING CENTER".
4. Autorizohet kryerja e regjistrimit vullnetar në regjistrin tregëtar pranë Qendrës Kombëtare të Bizneseve, e emërtimit tregtar të shoqërisë EBA 2020 sh.p.k, të referuar mësipër.
5. Ky Vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë EBA 2020 sh.p.k, do të hyjë në fuqi menjëherë dhe hartohet në 3 kopje origjinale dhe përbëhet nga gjithësej katër (4) faqe. Autorizohet Administratori i Shoqërisë EBA 2020 sh.p.k, që të bëjë regjistrimin e këtij Vendimi në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, duke vepruar vetë ose duke autorizuar një përfaqësues të posaçëm.
6. Secili nga Ortakët e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë EBA 2020 sh.p.k, përkatësisht, Ortaku Adrian Naço, Ortaku Enkel Bamllari, dhe Ortaku Besart Xhaferri, konfirmon votën "pro" dhe miratimin e tij pa rezerva të të gjithë përmbajtjes së këtij Vendimi Asambleje, nëpërmjet vendosjes së nënshkrimit të tij. U nënshkrua sot, me datë 20/02/2020.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
E ORTAKËVE TË SHOQËRISË EBA 2020 sh.p.k
ORTAKËT NËNSHKRUES



Adrian Naço (nënshkrimi)



Enkel Bamllari (nënshkrimi)

ENKEL BAMLLARI

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Enkel', written over a horizontal line.

Besart Xhaferi (nënshkrimi)

Besart Xhaferi

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'B. Xhaferi', written over a horizontal line.